

ANALIZË E SHKURTË

KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung

Shtator 2014

www.kas.de/kosovo

GJERMANIA SI PARTNER STRATEGJIK I KOSOVËS NË FUSHËN E ENERGJISË DHE EFIQIENCËS SË ENERGJISË

Lulzim Syla

Shoqata për Energji të Ripërtrishme e Kosovës
(SHERK)

Parathënie

Kjo analizë e përmbledhur i kushtohet në veçanti ndërtimit të raporteve në nivel strategjik ndërmjet shtetit tonë Republikës së Kosovës me Republikën e Gjermanisë në fushën e energjisë dhe eficientës së energjisë.

Sot më shumë se çdo gjë tjetër, vendi ynë ka nevojë për korniza analizash strategjike që do t'i sillnin të ardhmes këndvështrime alternative. Përkundër hapësirës së vogël gjeografike apo numrit të popullsisë, vendi ynë dekadat e fundit ka kaluar në transformime të ndryshme intensive gjë që na lejon të qartësojmë qëndrimet, analizat dhe praktikat strategjike të cilat i ndihmojnë një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë ekonomik dhe social. Dinamika e madhe e ngjarjeve politike, ekonomike e sociale na bën edhe më përgjegjës përcaktimin drejt një kornize përkrahuese e cila do të jetë si udhërrëfyes mbi rrugën që do të ndjekim për zhvillim e fëmijëve tanë, brezave të rinj duke ekuilibruar edhe aspektet tjera sociale, ekonomike e politike brenda dhe jashtë vendit.

Për tu përcaktuar për një partneritet strategjik me një shtet çfarë është Gjermania, duhet të kemi parasyshë paraprakisht shumë faktor dhe të bëhën analiza të thella gjeostrategjike. Për të ndërtuar një partneritet të tillë duhet njohje e thellë e kulturës, traditës, fesë, ekonomisë, politikës së atij vendi dhe shumë dimenzioneve tjera. Përmes kësaj analize të shkurtër synojë të nxisë diskutimin në këtë fushë e sidomos nga këndvështrimi i ndërtimit të marrëdhënjeve strategjike në fushën e ekonomisë duke u fokusuar veqanarisht në fushën e energjisë dhe eficientës së energjisë.

Arsyet për një partneritet të tillë janë të shumta duke filluar nga aspekti politik, gjeostrategjik, ekonomik, tregtar, kulturor, social, etj. Për arsye të profilit tim që vijë nga fusha e ekonomisë dhe biznesit, kësaj radhe trajtimi i kësaj teme do të fokusohet më tepër në fushën e bashkëpunimit ekonomik me fokus të veçant në fushën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme, eficientës së energjisë, industri e tregti dhe segmente që ndërlidhen me fushën e energjisë.

Kosova dhe Gjermania

Gjermania vlersohet si tregu më i madh në Evropë. Kontribuon me 20 përqind në GDP-në e përgjithshme të Evropës (EU-28) dhe është shtëpia e 16 përqind e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Bashkimit Evropian¹. Në aspektin ekonomik në bazë të dhënave tregtare, biznesit, doganave, administratës tatimore dhe organizatave hulumtuese del se Kosova ka një bashkëpunim të mirë me shtetin gjerman. Ky bashkëpunim ka mundësi dhe potencial të jetë shumëfish më i madh në të gjitha dimensionet ekonomike dhe sociale. Kosova ka pasë fatin që para gjatë dhe pas luftës ka pasë mbështetje të vazhdueshme nga qarqe të ndryshme politike, organizata, institucione financiare gjermane, që kanë zhvilluar projekte të ndryshme në ndihmë të zhvillimit të vendit tonë sidomos nga fusha e infrastrukturës dhe energjetikës.

Strategjia e energjisë dhe plani i veprimit i Kosovës për eficientë të energjisë

Kosova që nga paslufta nga viti 1999 e deri më tani përballlet vazhdimisht me furnizim jo të qëndrueshëm me energji elektrike. Kërkesat për energji gjithnjë janë në rritje ndërsa në anën tjetër nuk kemi ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese që do të përballonin kërkesën në rritje. Rreth 35% e energjisë elektrike në Kosovë përdoret për të ngrohur objektet banesore dhe objektet që janë pronë e shërbyesve (publik dhe privat)². Ndërsa amvisëria konsumon rreth 63% të energjisë. Por krahas konsumit të energjisë elektrike, në Kosovë konsumohet për ngrohje në sasi të mëdha edhe biomasa (druri) dhe derivatet e naftës. Për të reduktuar sadopak këtë varshmëri nga ky furnizim i mangët parashihen të ndërtohen kapacitet të reja të bashkëgjenerimit të energjisë duke ndihmuar në masë të madhe efikasitetin e përgjithshëm energjetik. Por njëkohësisht do të krijojë mundësi të reja që këto projekte të kenë mundësi të realizohen nga kompani gjermane sepse

¹ Eurostat 2013

² http://mzhe.rks.gov.net/repository/docs/PLANI_I_VEPRIMIT_I_KOSOVES_PER_EFICIENCE_TE_ENERGJISE_alb.pdf

kapaciteti mesatar parashihet të jetë rreth 200 MW për të plotësuar nevojat për ngrohje në aspektin afatgjatë deri në vitin 2023. Kosova i ka miratuar caqet indikative prej 9% apo 1021,18 ktoe, që duhet të arrihen në fund të periudhës 2010-2018, për të arritur vlerën prej 91,89 ktoe ose 1,068.68 GW energji të kursyer³.

Strategjia e re e Energjisë parasheh si prioritet ngritjen e nivelit të sigurisë së furnizimit të rregullt me energji elektrike duke krijuar një balancës mes furnizimit dhe kërkesës në treg. Në vitin 2017 parashihet dekomisionimi i njësisë Kosova A dhe njëkohësisht hapja e minierës së re në Sibovc që të ofrojë lëndë të parë për projektin energjetik Kosova e Re. Dhe si pjesë e veçant e strategjisë parashihet zhvillimi i burimeve të ripërtëritshme dhe pjesëmarrja në zhvillim të projekteve rajonale të tregut të energjisë⁴.

Gjithashtu janë parashikuar edhe masat për përmirësimin e efijencës së energjisë duke filluar me sektorin e amvisërisë dhe atë të industrisë.

Sektorin e amvisërisë - Në kuadër të këtij sektori janë parapa disa masa kualitative dhe kuantitative gjatë viteve në vijim:

- Termo-renovimi kompleks, duke përfshi sistemet e ngrohjes me kontrolle automatike, izolimet termale në ndërtesa,
- Depërtimi i GLN-së (Gaz i lëngëzuar i naftës) do të duhej të kontribuojë në zvogëlimin e kërkesës për ngrohje dhe gatim me energji elektrike, duke ulur edhe konsumin e drurit për ngrohje.
- Përdorimi i sistemeve të bashkëgjenerimit aty ku ka mundësi teknike siq është rasti i furnizimit me avull për ngrohje nga Termocentrali Kosova B.

- Promovimi i skemave të ngrohjes qendrore që të kontribuojnë në sigurimin e ngrohjes së ndërtesave shumëkatëshe.
- Promovimi i bojlerëve të rinj dhe efijent
- Instalimi i paneleve solare për ngrohje të ujit sanitar dhe përdorimi i paisjeve efikase shtëpiake që zvogëlojnë sasinë e energjisë elektrike të shfrytëzuar nga pajisjet elektrike shtëpiake⁵.

Sektorin e shërbimeve – Ndërsa në këtë sektor masat e parapara janë si vijon:

- Përgaditja e fushatave për vetëdijesim
- Depërtimi i fuqishëm i mazutit dhe GLN-së për ngrohje për të përmbyshur kërkesën për ngrohje për ta përdorur në vend të energjisë elektrike
- Përmirësimi i izolimit termik në ndërtesat ekzistuese publike dhe private të sektorit të shërbimeve dhe aplikim i Kodit të ri të Energjisë në ndërtim
- Futja e skemës së CHP (kombinimit të ngrohjes dhe energjisë)
- Realizimi i Auditimeve të Energjisë në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve dhe qendrave komerciale
- Rritje e efijencës në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve përmes masave tjera siq janë rritja e përdorimit të ndriçimit fluoreshent, futja e teknikave inteligjente elektronike, përdorimi i pajisjeve moderne elektrike, etj⁶.

³ http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/SE - Shqip_26.12.pdf page.19.

⁴ http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/Future%20Story/ECA/kosovo/Kosovo%20Eptisa%20Final%20Report_2013.04.13.pdf

⁵ http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/PLANI_I_VEPRIMIT_I_KOSOVES_PER_EFICIENCE_TE_ENERGJISE_alb.pdf fq.24

⁶ http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/PLANI_I_VEPRIMIT_I_KOSOVES_PER_EFICIENCE_TE_ENERGJISE_alb.pdf

Sektori i Industrisë - Kryesisht në këtë sektorë do të ketë synim të reduktohet konsumi i energjisë në transportin dhe bujqësi duke përfshi edhe kreditimin e produkteve të caktuara për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që ndikojnë në uljen e konsumit të energjisë elektrike dhe termike përmes aplikimit të teknologjive të avancuara.

Termocentrali i ri Kosova e re - Pavarësisht tentimeve dhe gatishmërisë së deritanishme të disa kompanive gjermane për të qenë pjesë e Termocentralit të ri dhe tërheqjes së tyre për kohë të përkohshme, nga ana e qeverisë tonë duhet të ketë shumë kujdes në trajtimin e këtij projekti duke pasë parasysh ekspertizën e lartë të kompanive gjermane në këtë fushë duke insistuar që gjithsesi edhe ata të jenë pjesë e garës ku Qeveria e Kosovës do të duhej të garantonte një transparencë të plotë gjatë evaluimit dhe shpalljes së fituesit për ndërtim të termocentralit.

Termocentrali i ri do të jetë i ndarë në dy njësi nga 300 MGW dhe do të plotësojë në masë të madhe kërkesat për furnizim të rregullt me energji dhe futja në funksion parashihet të bëhet në vitin 2018⁷.

Banka Botërore - Projekt 31 milion dollarë për efijencë të energjisë

Në kuadër të bashkëpunimeve që ka ndërtuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik me Bankën Botërore së fundmi ka rezultuar një projekt me interes shumë të madh për vendin tonë në fushën e efijencës së energjisë. Ky projekt ka ardhë si rezultat i një analize të gjendjes ekzistuese në fushën e energjisë dhe efijencës së saj duke audituar një numër të madh të institucioneve si shkolla, ambulanca, qendra spitalore, kopshte të fëmijëve, objekte qeveritare e komunale etj dhe kanë ardhë në vlerësim për të ndihmuar Kosovën me një projekt në vlerë prej 31 milion dollarë⁸, mjete të cilat do të shfrytëzohen enkas për rritjen e efijencës së energjisë përmes aplikimit të produkteve adekuate siq

janë: izolimet termike, panelet termike për ngrohjen e ujit sanitar, etj.

Bashkëpunimi në nivel lokal – komunal në fushën e energjisë

Ky segment vlerësohet si një nga shtyllat kyçe të implementimit të masave për efijencë të energjisë sepse mbi 45% e qytetarëve jetojnë në fshatra dhe kjo kryesisht bën që furnizimi me energji menaxhohet në nivel komunal. Një nga format e bashkëpunimit në nivel lokal do të ishte binjakëzimi me qytete gjermane që kanë përvojë sidomos në fushën e efijencës së energjisë duke shkëmbyer përvoja e duke mësuar shumë nga përvojat e institucioneve gjermane. Besëlidhja e Kryetarëve të Komunave ose siq quhet në origjinal "Covenant of Mayor"⁹ ku në kuadër të kësaj organizate janë me qindra qytete të Evropës që janë anëtarë të kësaj organizate kanë për qëllim përfshirjen e autoriteteve lokale dhe rajonale, vullnetarisht në projekte për të rritur efikasitetin e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në territoret e tyre. Gjithashtu është me rëndësi të veçantë të punohet në drejtim të pavarësisë dhe eliminimit të ndikimit të drejtpërdrejtë në furnizim me energji elektrike nga qendra. Në këtë segment parashihet të investohet shumë në nivel komunal sidomos në objekte publike me rëndësi të veçantë siq janë: shkollat, spitalet, ambulancat, qendrat sociale, objektet komunale, kopshtet e fëmijëve, etj.

Zhvillimi i sektorit të energjisë – investimet e qeverisë Gjermane në Kosovë

Qeveria Gjermane deri më tani konsiderohet si kontribuesi dhe donatori më i madh që nga paslufta prej vitit 1999 e deri tani në shumën prej 420 milion euro¹⁰. Nga këto mjete deri më tani në fushën e energjisë dhe të efijencës nga Qeveria Gjermane janë

⁷ http://mzhe.rks-qov.net/repository/docs/SE - Shqip_26.12.pdf fq.20

⁸ <http://www.worldbank.org/projects/P143055/kosovo-energy-efficiency-renewable-energy-project?lang=en>

⁹ http://www.covenantofmayors.eu/index_en.html

¹⁰ http://www.auswaertiges-amt.de/EN/Aussenpolitik/Laender/Laenderinfos/01-Nodes/Kosovo_node.html

investuar në Kosovë rreth 142.1 milion euro të implementuara nga banka KfW¹¹.

Projekti i radhës që është mbështetur nga qeveria gjermane është projekti i Termokosit ku do të bëjë të mundur rritjen e kapacitetit të furnizimit me energji termike për qytetin e Prishtinës nga Termocentrali Kosova B duke ulur koston operative të prodhimit deri në 50% dhe njëkohësisht duke reduktuar në masë të madhe lirim të gazrave me CO₂. Ky projekt është mbështetur edhe nga donatorë të tjerë si Bashkimi Evropian, Qeveria Suedeze dhe ajo e Luksemburgut e gjithashtu edhe nga Komuna e Prishtinës.

Përveq rehabilitimeve dhe furnizimeve me pajisje të ndryshme në Mihje në Bardh, Mirash dhe Termocentralet menjëherë pas lufte nga viti 1999, gjithashtu një ndër projektet më vitale për rrjetin energjetik të Kosovës është ndërtimi i largëpërquesit 400/100 Kv me gjatësi 240 km që do të jetë arteria kryesore e lidhjes me furnizim të ndërsjellt me energji elektrike nga Shqipëria ku qeveria gjermane në bashkëpunim me KfW ndihmojnë me 33.5 milion euro i cili është në ndërtim e sipër¹². Përveq projekteve të mëdha në infrastrukturë energjetike si largëpruesit apo ripartimet në termocentrale, qeveria gjermane ka mbështetur edhe shumë projekte tjera në koordinim me projektet e qeverisë për arritjen e caqeve të BE-së 20-20-20 që janë edhe prioritet i Strategjisë Kombëtare për Energji. Projektet tjera kanë qenë kryesisht të karakterit për ndërtimin e disa shkollave duke instaluar ngrohjet qendrore, sistemet izoluese, dritaret efikente etj. Ka pasë gjithashtu projekte me komuna që janë instaluar sisteme efikente të ndriqimit publik ku së bashku kalojnë vlerën e 5 milion euro deri më tani¹³.

¹¹ *Rehabilitation and modernisation in the Energy Sector – KfW Development Research.*

¹² http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=214&lang=sq

¹³ <https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Entwicklungsbank/About-us/Unsere-weltweite-Pr%C3%A4senz/Europa/Office-Kosovo/>

ARSIMIMI – EDUKIMI DHE TRAJNIMI NË FUSHËN E ENERJISË & EFIÇIENCËS SË ENERJISË

Kosova ka potencial të madh në fushën e resurseve humane me popullsi të re mbi 65 përqind nën moshën 35 vjeqare. Nëse i referohemi të dhënave 2013/2014 nga sektori i arsimit parauniversitar janë gjithsejtë 408.146 nxënës ku nga ta 102.213 janë segmenti i nxënësve të nivelit të mesëm dhe i lartë shkollor. Nga ky numër 46 përqind janë të regjistruar në Gjinnaze dhe 54 përqind në shkolla profesionale¹⁴. Ajo qka i mungon nxënësve të Kosovës janë kushtet e mirëfillta për edukim cilësor dhe bashkëkohor. Edhe pse numri i shkollave profesionale është 54 sosh ato fatkeqësisht nuk gjenerojnë kuadro të përgaditura për treg të punës e sidomos kur kemi parasyshë fushën energjisë dhe lëmive tjera ndërlidhëse mungojnë shumë kuadrot e kualifikuara.

Arsimi dhe formimi profesional – Asociacioni për nxitjen e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

Në mbështetje të GIZ-it gjerman me kërkesën edhe të bizneseve vendore kosovare është iniciuar këtë verë themelimi i Asociacionit për nxitjen e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë. Ky asociacion do të ketë për qëllim lobimin, fuqizimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja të rinjëve dhe profesionistëve që të zhvillojnë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme si: energji, energji e ripërtëritshme, instalime elektrike, elektronike, makinerike, etj. Ky asociacion mund të luaj një rol të rëndësishëm në përgaditjen e terrenit për investitorë gjerman që dëshirojnë të investojnë në fushën e energjisë në Kosovë.

BAU Akademia në Prishtinë

Me iniciativën e bizneseve private në Kosovë dhe mbështetje të Ambasadës Gjermane dhe GIZ është planifikuar ndërtimi i një qendre kompetence që do të ofrojë edukim cilësor në nivel të njëjtë si në Gjermani dhe certifikatat e lëshuara për metalpërpunues, industri druri, ndërtim, instalime elektrike, makinerike etj, do të

¹⁴ http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Shenime_Statistikore_2013_14_Arsimi_Parauniversitarr.pdf

njihen në të gjithë tregun e Bashkimit Evropian. Këto projekte mundësojnë sjelljen e investitorëve të huaj dhe na mundëson të përgaditemi për një integrim më të lehtë në BE. Kjo akdemi apo qendër trajnimi do të kishte luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përgaditjen e resurseve të reja humane që do të punonin në prodhim të produkteve apo shërbimeve në fushën e inxhinierisë elektrike, energjisë, eficiencës së energjisë, burimeve të ripërtëritshme etj.

Praktikat e bashkëpunimit mes institucioneve gjermane dhe Kosovës në fushën e energjisë - Vizitat studimore

Përveq mbështetjes në aspektin financiar për implementim të projekteve strategjike në fushën e energjisë nga institucionet dhe bankat gjermane, gjatë viteve të fundit karakteristikë e veçant ka qenë bashkëpunimi i mirë në këtë sektor në mes të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile dhe atyre gjermane siq janë projektet me GIZ (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) ku në vitin 2012 një grup i përzgjedhur nga Kosova nga institucione dhe biznese kanë shkuar në Gjermani përkatësisht në Republikën e Bajernit për një vizitë studimore e cila ka pasë për qëllim njoftimin më për së afërmi me trendet më të reja të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme, projektet komunale në fushën e eficiencës së energjisë dhe modelet e zhvillimit të projekteve të përbashkëta qeveri – akademi – biznes. Kjo ka qenë një përvojë jashtëzakonisht e mirë për të pa nga afër risitë, potencialet dhe mundësitë që ofron shteti gjerman për qytetarët e vet dhe njëkohësisht të ndajë këto përvoja edhe me vende tjera si mundësi e mirë bashkëpunimi në fushën e energjisë. Një praktikë e mirë e radhës është edhe bashkëpunimi i Odës Ekonomike së Dortmundit ku nga ky institucion është ofruar bashkëpunim përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ku si fokus përveq tjerash kanë edukimin e të rinjëve në fushat si: mekatronikë, elektronika, energjetika etj, si dhe mundësia e bartjes të përvojës së tyre akademike dhe profesionale në Kosovë.

Bashkëpunimi me Institucionet akademike Gjermane në fushën e energjisë

Gjermania karakterizohet me numrin më të madh të insituteve, qendrave hulumtuese dhe univerziteteve në nivel Evropian që merren me fushën e energjisë dhe eficiencës së energjisë.

Modelet e institucioneve siq janë Instituti Fraunhofer¹⁵, Instituti i Teknologjisë Karlsruhe¹⁶, Instituti për Energji dhe Ambient IUTA¹⁷, apo siq është Qendra Hulumtuese Helmholtz etj, janë institucione që mund të bashkëpunojmë në fushën e energjisë, eficiencës dhe burime të ripërtëritshme të energjisë. Edhe sa i përket Univerziteteve dhe qendrave trajnuese prin në nivel evropian në trajtimin e qështjeve të energjisë dhe eficiencës së saj.

Praktimi i sistemit dual në teori dhe praktikë sikur në Gjermani do të ishte një model i përkryer për një shkollim që do të gjeneronte punësim në këta sektorë.

Për të ngritur edhe më tutje nivelin e bashkëpunimit në fushën e edukimit dhe arsimimit me shtetin gjerman duke përfutuar më tutje drejtpërdrejt edhe në zhvillim ekonomik, rekomandojmë që institucionet tona përkatëse duhet të integrojnë gjuhën gjermane si lëndë mësimore që nga shkolla fillore e deri tek univerzitetet. Kjo do të krijonte edhe një parakusht për mundësi të gjenerimit më të madh të punësimit dhe rritjes ekonomike duke i ofruar tregut gjerman edhe një mundësi më shumë. Për këtë shkak Gjermania shpërndan çdo vit bursa përmes Shërbimit Gjerman për Shkëmbim Akademik (DAAD) për qëndrime për studime, u mundëson gazetarëve, inxhinierëve, mjekëve kosovar pjesëmarrjen në udhëtime në Gjermani dhe nxit bashkëpunimin ekonomik e kulturor, apo zgjerimi i bashkëpunimit në shkëmbimin e të rinjëve në fusha profesionale teknike për të dërguar për praktika pune në kompanitë gjermane për periudha disa mujore. Institucionet përgjegjëse për edukim të vendit tonë duhet të krijojnë politika zhvillimore që përcaktojnë krahas edhe fushat me interes siq është prodhimi i

¹⁵ <http://www.fraunhofer.de/>

¹⁶ <http://www.kit.edu/research/6717.php>

¹⁷ <http://www.iuta.de/>

resurseve humane në fushën e energjisë dhe komponenteve tjera përcjellëse.

Vizita e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare në Berlin

Një përvojë tjetër shumë e dobishme ka qenë vizita e një grupi të bizneseve në fund të vitit 2013 ku si qëllim kishin takimet me biznese në Odën Ekonomike të Potsdam në Berlin ku mes vizitave të ndryshme bizneset patën rastin të shohim projektet e fundit nga lëmia e energjisë dhe efijencës me çrast vizituan biznese nga fusha e prodhimit të energjisë nga era përmes aerocentraleve, panele diellore, sistemeve me biogas dhe biomasë.

Konferenca vjetore për Energji nga Evroenergie

Një tjetër formë e ndërtimit të raporteve strategjike dhe afatgjate në fushën e energjisë është edhe organizimi vjetor që nga viti 2012 i Konferencës vjetore për energji të organizuar nga kompania Evroenergie nga Kosova me partner gjerman. Kjo konferencë sjell çdo vit ekspert të nivelit shumë të lartë nga fusha e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë, efijencës, etj, kryesisht nga Gjermania përfshirë institucione nga qeveria gjermane që merren me fushën e energjisë dhe efijencës. Konferenca çdo vit po merr formën e vet duke ofruar mundësi të mira për prezentim dhe mundësi bashkëpunimi për biznese gjermane që kanë interes të investojnë në fushën e energjisë në Kosovë. Kjo konferencë duhet të vlerësohet nga qeveria si mundësi shumë e mirë për prezentim të projekteve madhore para investitorëve potencial gjerman.

Diaspora kosovare në Gjermani – Potencial për bashkëinvestime në fushën e energjisë

Sipas të dhënave jo të verifikuara në mënyrë institucionale nga ana e autoriteteve përkatëse të vendit tonë, në Gjermani jetojnë mbi 320,000

shqiptarë nga Kosova¹⁸. Mbi 6500 studentë kosovar që janë duke studiuar në nivel bachelor, master e doktoraturë në Gjermani¹⁹. Ndërsa çka është edhe më e veçant dhe shumë element i fuqishëm ekonomik është numri prej mbi 18-25 mijë biznese të hapura dhe që menaxhohen nga qytetarë të Kosovës që jetojnë në Gjermani. Ky grup i bizneseve është një potencial jashtëzakonisht i madh e shumë pak i shfrytëzuar nga ne sidomos vitet e fundit pas luftës. Fatmirësisht tash së fundi, para një viti në muajin tetor 2013 në Köln të Gjermanisë kisha kënaqësinë të jem pjesmarrës në themelimin e Unionit të parë të bizneseve shqiptare nga Kosova në Gjermani²⁰. Ky union do të grumbullojë bizneset në një ombrellë duke krijuar një fuqi të madhe financiare dhe intelektuale e cila do të mund të artikulojë më mirë kërkesat ndaj vendlindjes së tyre dhe do të rrisë bashkëpunimet edhe më shumë me bizneset në Kosovë. Potenciali investues i tyre nuk është shfrytëzuar dhe se fuqia e tyre financiare është në miliarda euro. Diaspora jonë gjithashtu është një rezervë e rëndësishme e burimit njerëzor të përgatitur dhe të kualifikuar për procesin e integritimit evropian. Të hyrat zyrtare sipas Bankës Qendrore vetëm gjatë vitit 2012 diaspora ka sjellë rreth 605 milion euro para të gatshme²¹. Në kuadër të këtij segmenti, lidhja e partneriteteve mes bizneseve shqiptare në Gjermani dhe bizneseve gjermane atje mundëson shumë më lehtë depërtimin në tregun e Kosovës që këto kompani të futen në prodhim apo shërbime në fushën e energjisë dhe efijencës së energjisë.

Energjia & Efijencia e energjisë - Prodhimi & Shërbimet - Fushat dhe mundësitë e bashkëpunimit

Kosova ka potencial të madh të resurseve humane që nuk janë të aktivizuara në fuqi punëtore dhe shumica e tyre janë të rinj dhe me mundësi të mëdha për

¹⁸ <http://medrks-qov.net/wp-content/uploads/2013/09/Shqip-Strategjia-per-Diasporen-dhe-plani-i-veprimit-versioni-i-aprovuar-ne-Qeveri.pdf>

¹⁹ Ambasada e Kosovës në Gjermani

²⁰ <http://union-business.de/>

²¹ http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK_BOP_Nr12_2012.pdf

aktivizim në punë, prodhim e shërbime të ndryshme. Sipas raporteve të Bashkimit Evropian edhe pse Kosova njihet si vend agrar ku përveq potencialeve të mëdha në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit malor, vendi ynë ka potencial të madh në fushën e prodhimit të makinerisë, përpunimit të metaleve, drurit, industri automobilistike, ndërtimtari, elektroindustri, prodhim të tekstilit, industri kimike, shërbimeve outsourcing (nga distanca) siq janë teknologjia informative me një potencial shumë të madh në fushën e energjisë dhe efijencës së energjisë që të ofrojë shërbime edhe në tregun gjerman. Por për të arritur ti tërheqim investitorët gjerman në Kosovë duhet të përgaditemi shumë mirë dhe të jemi pragmatik. Puna e parë që duhet të bëjmë është ngritja substanciale e cilësisë së edukimit sidomos në shkolla profesionale dhe degët teknike në univerzitetet. Këtu nevojitet një ndryshim rrënjësor në trajtimin e kurikulave që të jenë në harmoni me kërkesat e tregut dhe kërkesat e ekonomisë gjermane dhe asaj evropiane. Të pajisim shkollat me laboratore përkatëse dhe diploma të jetë e vlefshme në gjithë tregun evropian. Një sistem gjyqësor i fuqishëm dhe transparent krijon parakushtet për rritje të besueshmërisë së investitorëve për të pa Kosovën si destinacion për biznes dhe investime.

Potenciali investues – zhvillimor

Sipas raporteve të punuara nga kompania Evroenergie në Prishtinë e veqarisht në punimin e fundit "Proceset e reja për krijimin e vlerës së shtuar në sektorin e metalit për përmirësim të teknologjive të energjisë (BRE & EE)²² kanë dale të dhëna shumë interesante për potencialet e tregut tonë duke u fokusuar sidomos në bashkëpunimin me bizneset gjermane për arsye të kompanive të fuqishme me eksperiencë të lartë, tregje të zhvilluara dhe përpunura, resurse humane të kualifikuara dhe afërsi në komunikim e transport Kosovë-Gjermani. Nga viti 1999 deri më sot Qeveria Gjermane ka mbështet sektorin energjetik të Kosovës me 127 milion euro të cilat janë menaxhuar nga Banka KfW²³. Edhe pse nuk ishim të kujdesshëm me procesin

e privatizimit me ndërmarrjet që kanë shtylla kryesore e ekonomisë dhe eksportit përsëri diqka nga to kanë mundësi të rivitalizohen sidomos në pjesën e përpunimit të metalit, makinerisë dhe energjisë. Shtetet e regjionit ballkanik posedojnë një potencial të lartë të mundësive të prodhimit në fushën e përpunimit të metaleve që ndërlihet ngushtë me prodhimin e produkteve në fushën energjisë, energjisë së ripërtëritëshme, efijencës etj. Në Kosovë ekzistojnë afër 100 kompani private në fushën e makinerisë dhe përpunimit të metaleve që janë në gjendje të prodhojnë edhe për tregje të jashtme²⁴.

Për të pasë një pasqyrë reale mbi mundësitë dhe potencialet në Kosovë nevojitet një hulumtim i thellë fillimisht mbi gatishmërinë e njerzve për punë, së dyti gatishmërinë për punë në prodhim e treat gatishmëria për mësim të reja praktike, çertifikime, licencime etj. Pas kësaj do të kemi një raport të detajuar se në qfarë numra dhe kapacitet mund t'i ftojme investitorët gjerman për të investuar.

Nëse i referohemi të dhënave të shtetit gjerman mbi numrin e kompanive në fushën e energjisë dhe dhe efijencës del një numër me potencial të jashtëzakonshëm, ku vetëm Berlina me Brandenburg si regjion ka rreth 5000 kompani nga fusha e energjisë me mbi 50,000 të punësuar me të hyra rreth 15 miliardë euro në vit²⁵. Ndërsa numri i përgjithshëm i bizneseve të përgjithshme në këtë fushë në gjithë Gjermaninë është me dhjetra mijëra.

Ndërsa sipas raportit të vitit 2012 të "World Energy Outlook 2012"²⁶ të publikuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Energji - IEA, nga viti 2013 deri në vitin 2035 në botë parashihen të investohen rreth 11.8 trilion dollarë në nivel botëror vetëm në fushën e efijencës së energjisë dhe që pritet të rezultojë në: 17.5 trilion në zvogëlim të fakturave për karburante, 50% zvogëlim të ulje të kërkesës për energji në nivel

²² Studim – Ekonomia Energjetike – Evroenergie & GIZ (German Cooperation)

²³ KfW – Development Research – Rehabilitation and modernization in the Energy Sector in Kosovo

²⁴ Proceset e reja për krijimin e vlerës së shtuar në sektorin e metalit për përmirësim të teknologjive të energjisë (BRE & EE) Studimi nga Kompania Evroenergie, Prishtinë

²⁵ <http://www.energietechnik-bb.de/en/home>

²⁶ <http://www.worldenergyoutlook.org/publications/woe-2012/>

botëror dhe rreth 1.3 trilion dollarë zvogëlim në ndërtim të infrastrukturës së re për energji.

Ndërsa sipas publikimit të fundit nga EREC - "Re- thinking 2050", vizioni i Bashkimit Evropian është që në vitin 2050 furnizimi me energji të bëhet 100% nga burime të energjisë së ripërtitëshme²⁷. Në nivel të evropian, Gjermania është lider në fushën e teknologjisë së efijencës së enegjisë me një qarkullim rreth 67 miliardë euro në vit me tendenca të dyfishimit të qarkullimit për pak vite të ardhshme²⁸. Në 20 vitet e ardhshme në Gjermani bazuar në tendencat për të arritë kuotën prej 25 përqind në kursim të energjisë parashihen të investohen rreth 540 miliardë euro si të domosdoshme, ku deri më tani janë investuar në këtë fushë për hulumtim dhe zhvillim rreth 13 miliardë euro. Këto të dhëna flasin shumë, flasin për një potencial të madh ku Gjermani vlersohet si një ndër prodhuesit më të mëdhenjë në botë të produkteve nga fusha e energjisë, energjisë së ripërtitëshme dhe efijencës së energjisë apo shkurt BRE-ve dhe EE-ve. Këto të dhëna duhet të shihen me shumë seriozitet nga ndërmarrësit dhe prodhuesit në Kosovë se mundësitë për prodhim në Kosovë për eksport në Gjermani dhe nga Gjermani për në vendet e treta është shumë i madhë i mundëshëm dhe i prekshëm. Ndërsa në aspektin lokal në fushën e Efijencë të Energjisë Kosova ka planin e veprimit të efijencës për periudhën 2010-2018, i cili në vetvete ka cakun prej 9 përqind²⁹. Bizneset e Kosovës kanë guximin, janë ndërmarrës të mirë po nevojitet zhvillim të shkathtësive teknike, operative, dhe shitëse për tregje të jashtme.

Numri i produkteve që mund të prodhohen në vendin tonë dhe të eksportohen qoftë në tregjet gjermano-folëse apo në vende të tjera në fushën e eficienës së energjisë është shumë i madh. Po veqojë disa nga këto segmente që kanë edhe mijëra nënprodukte tjera siq janë: orë elektrike inteligjente, sisteme izoluese, teknologji për ngrohje dhe ftohje, paisje efijente për shtëpi, poqa ekonomike, sisteme të

kogjenerimit të energjisë, pompa, kompresorë të ajrit, sisteme të paneleve solare, izolime nga xhami, pjesë përbërëse të sistemeve të ngrohjeve me biogas, biomasë etj.

Marrëveshjet e sipërpërmendura preferenciale me shtete të caktuara, CEFTA dhe lista e produkteve për eksport të liruara nga dogana janë mundësi të mëdha që sidomos në sektorin e energjisë të prodhohen me dhjetra apo qindra produkte për eksport nga Kosova në Gjermani apo në vendet e treta. Ka nevojë për personel të përgaditur që nje proceset e prodhimit, eksportin, kalkulimet, marrëveshjet ndërkombëtare, cilësinë e prodhimit etj, sepse tregjet e jashtme kanë specifikat e tyre të veqanta që duhet respektuar e trajtuar me kujdes.

Investimet e kompanive private Gjermane në Kosovë në fushë e Energjisë

Sipas të dhënave statistikore të Bankës Qendrore të Kosovë dhe MTI-së vlersa e investimeve vetëm nga viti 2007-2012 janë 374,95 milion euro, krahasuar me vendet tjera prin dukshëm ndaj vendeve tjera siq janë Britania e madhe me 292 milion euro duke pasuar me Slloveninë 210 milion euro etj³⁰. Kosova vetem ne vitin 2012 ka importuar nga Gjermania rreth Gjermania 292 milionë Euro, afro 10 përqind të totalit të importit, duke u bërë Gjermania vendi i dytë për eksporte në Kosovë pas Maqedonisë. Numri i bizneseve gjermane në Kosovë është në gjithnjë në rritje.

Xella Kosova – Tregim i suksesshëm

Si model i mire i një investimi të suksesshëm gjerman që prek sadopak segmentin e efijencës së energjisë është edhe investimi gjerman nga kompania Xella International ku ka investuar rreth 12 milion euro në prodhim të linjave të prodhimit të blloqeve të ndërtimit që indirekt prek segmentin e efijencës së energjisë sepse janë produkte termoizoluese dhe krijojnë efekte pozitive zingjirorë³¹.

²⁷ <http://www.kas.de/kosovo/sq/publications/34821/>

²⁸

<http://www.qtai.de/GTAI/Navigation/EN/Invest/Industries/Energy-environmental-technologies/energy-efficiency.html>

²⁹ <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,250>

³⁰ Banka Qendrore – Raporti vjetor mbi Investimet e jashtme direkte 2012.

³¹ http://www.kosova.xella.com/#_sub1212

Evroenergie – Tregim i suksesshëm

Edhe kompania Evroenergie në Kosovë është një tregim i suksesshëm i një partneriteti strategjik mes bizneseve nga Gjermania dhe atij në Kosovë. Kjo kompani merret me shërbime outsource nga Kosova për tregun gjerman ekskluzivisht në fushën e energjisë, eficiencës së energjisë, energjisë së ripërtëritëshme etj, duke ofruar shërbime nga distanca për klient të ndryshëm dhe projekte të ndryshme në fushat e sipërpërmendura. Ky model jep shpresa dhe është një tregues shumë i mire se në Kosovë mund të zhvillohet një biznes i qëndrueshëm edhe nga kjo fushë. Sipas raportit të fundit të Forumit Ekonomik Botëror, Gjermania renditet si shteti i parë në botë në fushën e implementimit të masave për eficiencë të energjisë, ku vetëm në vitin 2013 shteti ka stimuluar programe nxitëse dhe kredi në vlerë rreth 34 miliardë euro duke u fokusuar në sektorin privat me qka ka rezultuar me rreth 30% eficiencë të energjisë si rezultat i ndrrimit të teknologjisë së vjetër me të re dhe masave tjera në procese të prodhimit³². Gjermania pritet që deri në vitin 2020 të reduktojë konsumin e energjisë deri në 20% ndërsa deri në vitin 2050 deri në 50% ulje të konsumit të energjisë³³.

Marrëveshjet e bashkëpunimit ekonomik në fushën e energjisë dhe eficiencës

Kosova deri me tani nuk ka të nënshkruar asnjë marrëveshje të nivelit të lartë ekonomik që dëshmon ndonjë gatishmëri për thellim të ndonjë bashkëpunimi në këtë fushë. Për të ndërtuar raporte në nivel strategjik dhe afatgjatë, vendi ynë duhet të propozojë dhe nënshkruaj marrëveshje të ndryshme të karakterit ekonomik, social, kulturor, sigurisë, politik, etj.

Gjermania ka qenë një ndër partnerët kryesor të Kosovës në fushën e donacioneve dhe financimit të projekteve madhore në vendin tone sidomos në fushën e energjisë dhe infrastrukturës. Vetëm për vitin 2013 ka përgatitur mbi 28 milionë euro për politikat

zhvillimore në Kosovë, ndërtimin e infrastrukturës, institucioneve dhe arsimit. Rasti më i freskët është financimi i Linjës së Interkoneksionit për energji 400kV mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Mundësitë tjera që mund të shfrytëzohen në partneritet me biznesin gjerman janë 8,336 produkte industriale tarifa doganore e të cilave do të jetë 0 mënjëherë pas ratifikimit të marrëveshjes me Turqinë. Kosova aktualisht është duke përfitur nga Masat Autonome Tregtare të vendosura njëanshëm nga BE-ja me Rezolutën e Këshillit (2007/2000) e cila mundëson qasje në tregun e BE-së pa taksa doganore për disa prodhime të Kosovës. Poashtu Kosova përfiton nga Sistemi i Pergjithshëm i Preferencave (SPP) me SHBA-në, ku prodhimeve nga Kosova u mundësohet që nga viti 2008 të përfitojnë duke eksportuar pa taksa doganore afër 3500 produkte në tregun e SHBA-së. Marrëveshje të tilla preferenciale vendi ynë ka edhe me Norvegjinë dhe Japoninë për një numër të kufizuar të mallrave³⁴. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve kompanitë gjermane mund të përfitojnë shumë nga shfrytëzimi i këtyre marrëveshjeve që ka Kosova e veqanarisht në produktet industriale përfshi edhe ato të sektorit të energjisë dhe eficiencës së energjisë.

Bashkëpunimi me bizneset, Odat ekonomike

Një ndër treguesit më të freskët të një bashkëpunimi me biznese nga ana e qeverisë gjermane, përkatësisht Odës Ekonomike të Nynbergut në Gjermani ishte mbështetja e dhënë dy bizneseve nga Kosova asaj Elen dhe Entermedia për të hapë për herë të parë pas lufte në mënyrë zyrtare degët e saj edhe në tregun gjerman, duke shënuar kështu edhe një pikë të rëndësishme të bashkëpunimit mes biznesit kosovar dhe atij gjerman³⁵. Ky është vetëm fillimi i një mundësie të re për bizneset tona. Vendi ynë ka mundësi të ofrojë edhe shumë biznese tjera që mund të punojnë edhe në tregun gjerman qoftë duke ofruar shërbime apo edhe eksporte të prodhimeve të ndryshme. Në vitin 2009 si iniciativë e përbashkët në Gjermani është themeluar Oda Gjermano-Kosovare (www.dkqw.de) në Berlin kryetar i

³² <http://www.thecoreport.com/green-blogs/area/usa/germany-leads-the-world-in-energy-efficiency/>

³³ <http://www.evroenergie.com/>

³⁴ *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Departamenti i Tregtisë, Divizioni për mbrojtje të Tregut*

³⁵ <http://koha.net/?id=27&l=1112>

së cilës është ish-deputeti gjerman i CDU-se, Dr. Friedbert Pflüger. Ndërsa në prill të vitit 2012 kemi themeluar Odën Gjermano - Kosovare (<http://www.kdvw.org>) në Prishtinë e cila numëron një numër të madh të bizneseve gjermane dhe kosovare që kanë partneritet me biznese nga Gjermania. Dhe së fundi bashkimi i bizneseve të diasporës në Gjermani është bërë përmes krijimit të Unionit të bizneseve Kosovare (<http://www.union-business.de>) në Gjermani. Këto organizata janë shtylla të fuqishme për një bashkëpunim mes dy ekonomive tona. Në Kosovë janë të regjistruara 384 biznese gjermane³⁶.

Deri tani kanë munguar aktivitete të cilat diskutohet bashkëpunimi ekonomik, forumet ekonomike, takimet me biznese nga dy vendet etj. Organizimi në baza vjetore i një Forumi Ekonomik ku do të bisedoheshin temat e bashkëpunimit nga biznesi, industria, tregtia, etj, do të ishin shumë të vlefshme për një intensifikim të kontakteve mes dy ekonomive.

Rekomandime të tjera për fuqizim të marrëdhënjëve Kosovaro-Gjermane

Me qëllim të fuqizimit të raporteve aktuale dhe ndërtimit të raporteve tjera në fushëveprime tjera do të rekomandoja një sërë projekte dhe aktivitete që do të ndihmonin këtij procesi në dobi të dy palëve siq është:

- Intensifikimi i marrëdhënjëve ekonomike me shtetin gjerman përmes vendosjes së atashëve ekonomik në Ambasadat dhe Konzullatat e Kosovës në Gjermani.
- Organizimi në nivel ambasadash dhe oda ekonomike të vizitave studimore në kompani prodhuese dhe shërbyese, përfshi edhe panairret e veqanta për energji, burime të ripërtëritëshme dhe eficiencë nga të dy vendet.
- Krijimi i një databaze (uebfaqe) në internet e cila do të mundësonte takimin e kompanive të

ndryshme nga dy vendet me qëllim të shkëmbimit të interesave, produkteve apo shërbimeve të caktuara nga fusha e energjisë, burimeve të ripërtëritëshme dhe eficiences duke krijuar një mundësi të lehtë komunikimi, përfshi material informuese për hapje të bizneseve, investimet, resurset humane, informata nga fusha me interes të veçant, etj. Regjistrimi i bizneseve në databaza të projekteve dhe kompanive siq janë www.ixpos.de etj.

- Organizimi i një Forumi Ekonomik vjetor ose çdo dy vite në të dy vendet, duke organizuar me këtë rast edhe javën e bizneseve gjermane në Kosovë dhe anasjelltas.
- Organizimi i një mëngjesi të përbashkët një herë në muaj do të ishte i dobishëm gjithashtu për rrjetëzim të bizneseve.
- Bashkëpunimi intenziv me bizneset e diasporës dhe identifikimi i tyre në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve mes odave ekonomike të sipërpërmendura dhe ambasadave përkatëse, ku përmes rrjetit të diasporës mund të integrohen edhe biznese tjera gjermane që kanë besueshmëri tek këto biznese.
- Përgaditja e kuadrove profesionale qoftë në nivel të shkollave profesionale dhe akademike me për të qenë në hap me kërkesat e tregut dhe investimet e jashtme. Ndarje të fondeve të veqanta nga ana e shtetit tone për drejtime deficitare dhe trajnime në qendra, institute e akademi në Gjermani.
- Mbështetje e veçant e kompanive prodhuese dhe shërbyese të Kosovës që kanë synim tregun gjerman, qoftë me mejte financiare apo edhe mbështetje teknike për pjesmarrje në panairre, trajnime, etj.
- Analiza rreth potencialeve për prodhime dhe shërbime për eksport dhe raporte

³⁶<http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2002%202014.pdf>

përmbajtësore mbi ecuritë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vende, etj.

- Mbështetje institucionale nga ana e qeverisë kur ka projekte të fuqishme duke realizuar vizita të përbashkëta tek investitorët potencial për të treguar seriozitet dhe gatishmëri për mbështetje të projekteve të mëdha nga fushat e sipërpërmendura.

Përmbledhje

Eshtë koincidençë e mirë që ky punim shkruhet me rastin e 15 vjetorit të ndërtimit të raporteve diplomatike të vendit tonë me Republikën Federale të Gjermanisë menjëherë pas lufte. Trajtimi i shtetit gjerman nga ana e shtetit tonë meriton një vëmendje të veçantë dhe fuqizim të raporteve të ndërsjellta në çdo aspekt duke filluar nga kultura, arti, ekonomia, politika etj. Arsyet e sipërpërmendura mendojnë se janë bazë e fuqishme për të filluar të mendojmë drejt përcaktimit të partnerëve strategjik afatgjatë dhe përcaktimit të prioriteteve në mënyrë të anasjelltë. Fuqizimi i marrëdhënjëve ekonomike, tregtare, arsimore dhe kulturore janë të një rëndësie të veçantë për vendin tonë. Fatet dhe dinamikat e ngjarjeve politike ka bërë që Kosova të ketë marrëdhënje të hershme me Gjermaninë por tani si rezultat i zhvillimeve ekonomike-politike ka bërë që Gjermania të jetë atdheu dhe vendi i punës për qindra mijëra shqiptarë nga Kosova. Kjo situatë pashmangshëm na krijon edhe obligime të veçanta ndaj kësaj pjese të popullatës tonë atje duke hapë rrugë të reja bashkëpunimi qoftë përmes diasporës dhe vlerave që kanë ndërtuar ata për dekada me rradhë. Ky komunikim dhe bashkëpunim duhet të çmohet shumë, të ruhet dhe të përcjellat edhe tek brezat e rinj.

Energjia do të jetë një nga fushat me interes strategjik për të gjitha vendet në botë, nëse ke energjinë ke shtetin, nëse nuk ke energjinë do të jesh gjithnjë i varur nga tjerët. Prandaj kjo fushë duhet të shihet me syqeltësi sepse parashihet të jetë si faktor determinues i zhvillimit ekonomik të Evropës. Shfrytëzimi i këtyre hapësirave për bashkëpunim qoftë në prodhim apo shërbime krijon një zingjirë të tërë vlerash në dobi të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Rreth autorit

Lulzim Syla punon në kompaninë Elen si Partner Menaxhues, përkatësisht merret me zhvillimin strategjik të kompanisë. Elen është kompani e specializuar në fushën e elektro-energjetikës. Përveq angazhimeve në Elen, z. Syla është këshilltar në disa kompani private në Kosovë. Studimet bazike i përfundoi në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, në degën Menaxhment&Infomatikë ndërsa është i Certifikuar si trajner në fushën e Menaxhimit Strategjik nga Instituti WiFi Austri. Gjithashtu ka qenë trajner i biznesit për projekte të ndryshme private dhe të Komisionit Evropian. Eshtë bashkë-themelues i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe kryesues i Komitetit për energji në kuadër të OEGJK-së.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung
Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000/Pristina
Telefon +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
www.kas.de/kosovo